

V E N D I M
Nr.348, datë 3.7.1995

PËR KËSHILLAT MBIKQYRËS TË SHOQËRIVE SHTETËRORE

Në mbështetje të neneve 8 dhe 18 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I

1.Numri i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës të shoqërive publike që do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve shtetërore, të jetë:

- 3 veta për shoqëritë që kanë një numër të punëruarish deri në 500 veta;
- 6 veta shoqëritë që kanë një numër të punësuarish mbi 500 deri në 1200 veta;
- 9 veta për shoqëritë që kanë një numër të punësuarish mbi 1200 veta.

2.Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës duhet të jenë specialistë të dikastereve ose seksioneve të organit të pushtetit lokal, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë a të përafërt me sektorin ku bën pjesë shoqëria. Anëtarë të këshillave mbikëqyrës mund të caktohen edhe punonjës të institucioneve kërkimore-shkencore, të universiteteve, si dhe specialistë në pension.

2/3 e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës emërohen nga ministri i Financave

Ata duhet të kenë aftësitë e duhura për të drejtuar e kontrolluar veprimtrinë ekonomike e financiare të shoqërive.

Për shoqëritë e veçanta të karakterit ushtarak anëtarët e këshillit mbikëqyrës, që emërohen nga ministri i Financave, zgjidhen ndër punonjësit e ministrive përkatëse, sipas propozimeve të bëra nga këto të fundit.

Një nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jetë specialist në fushën e ekonomisë dhe financës.

Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillit mbikëqyrës punonjës të organeve që kryejnë funksione kontroll-revizio, qofshin këyo organe qendrore apo lokale. Nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës gjithashtu persona që janë emëruar drejtorë të shoqërive publike, ose që janë drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara në shoqëri tregtare, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3.Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës do të përbëhet:

a)nga shpërblimi i ifiks, i cili do të jetë jo më shumë se 30 për qind të pagës së drejtorit të shoqërisë publike, për kryetarin e këshillit mbikëqyrës, dhe jo më shumë se 20 për qind për anëtarët e këshillit mbikëqyrës;

b)nga shpërblimi i ndryshueshëm në varësi nga fitimet e shoqërisë, i cili do të jetë më shumë se 50 000 lekë në vit për kryetarin dhe jo më shumë se 360000 lekë në vit për anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

Masa e shpërblimit të mdryshueshëm caktohet nga drejtori i Drejtorisë së Shoqërive publike, pas miratimit të llogarive vjetore të shoqërisë. Shërblimi i ndryshueshëm nuk mund të jepet në asnjë rast si paradhënie.

4.Në rast kur një person është në më shumë se sa në një këshill mbikëqyrës, shpërblimi fik dhe ai i ndryshueshëm që jepet nga secila shoqëri, do të jetë:

a)75 për qind e shumva të përcaktuara në pikën 5 të vendimit, kur personi merr pjesë në dy këshilla mbikëqyrës;

b)60 për qind e shumave të parashikuara në pikën 5 të këtij vendimi, kur merr pjesë në 3 këshilla mbikëqyrës.

5.Shërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës caktohet në aktin e emërimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

